



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-12367

Dt. 31.05.2018

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, lëshon këtë

VENDIM (për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	ADEM (RAMADAN) MAHMUTAJ, nga Gjakova		
Adresa:	Rruga "Nimon Ferizi" nr.6		
Telefoni:	043 781 664	Emaili:	

Emri i Projektit:	Objekt i banimit individual – shtëpi banimi, me etazhitet P+1		
Emri i Projektuesit:	Ndërmarrja projektuese ndërtimore N.P.N."MURR – ING"-Pejë.		
Adresa:	Pejë		
Telefoni:	044 138 133	Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:		
Adresa: Rruga "Nimon Ferizi".		
Zona(t) Kadastrale: Gjakovë-J-Qytet	Nr. i parcelave kadastrale: 5105/7	GPS Koordinatat:

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtim i ri ☒	Rindërtim ☐ Riparim ☐
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I ☒	Kategoria II ☐
Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po ☐ Jo ☒
Përshkrimi: Objekt i banimit individual – shtëpi familjare, me etazhitet P+1	

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore z. **ADEM (RAMADAN) MAHMUTAJ**, nga Gjakova i lejohet ndërtimi i objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual – shtëpi familjare, me etazhitet P+1, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit për ndërtim $S= 262.25 \text{ m}^2$.

Përdhesa: (Sip,Bruto): $S= 148.18 \text{ m}^2$

Kati i parë: (Sip,Bruto): $S= 114.07 \text{ m}^2$

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Të vendosë tabelën informuese në vend ndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vend ndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

Arsyetim

Aplikuesi **ADEM (RAMADAN) MAHMUTAJ**, nga Gjakova, me banim në rrugën “Nimon Ferizi”, pn përmes kërkesës së evidentuar me nr. 07/351/01-12367, dt. 03.05.2018, të parashtruar DUMM-së, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual – shtëpi familjare, me etazhitet P+1, në ngastrën kadastrale me numër 5105/7, ZK: Gjakovë-J-Qytet, në pronësi të lartë përmendurit.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031 dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 05.02.2018, të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.
- Kopjen e planit të datës 19.12.2018 (fotokopje) së bashku me Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) me numër të lëndës 6350/17 të datës 19.12.2018, pronësi të Adem (Ramadan) Mahmutaj nga Gjakova të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Kushtet ndërtimore me nr.07/351/01-24605, dt.07.02.2018, të lëshuar nga DUMM.
- Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430/a/487, të datës 19.12.2017.
- Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, nr. 460 të datës 15.02.2018.
- Pëlqimin nga K.R.U. "Gjakova" Sh.A. Gjakovë, nr. 336 të datës 13.02.2018.
- Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, dt. 08.02.2018.
- Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Postën e Kosovës, filiali në Gjakovë me datë 26.05.2018.
- Projektin kryesor, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar Ndërmarrja projektuese ndërtimore N.P.N."MURR – ING"-Pejë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 899.00 Euro.


Shtojcë: Lejes së ndërtimit i bashkëngjitet: Plani i Situacionit së bashku me kushte lokacioni, me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, në përpjesë 1:500 të datës 05.02.2018, të vërtetuar nga DUMM-Gjakovë.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë për Punë Inspektuese,
- Arkivit.

Zyrtar i lartë për çështje juridike


Zenel Shabani, jur. i dipl.

Drejtori



Arben Bakalli, jur. i dipl.

K.K. GJAKOVË

Z.K. : Gjakovë j. Qytet

Ng. nr. 5105-7

PLAN SITUACIONI P=1:500



13.05.2017
Takeometri preqize
Auto CAD 2004

Punoi : *Khelal F. Zhubi inxh. i dip. i gjedh.*

Vërtetoi: N.P.SH. "GELI" Gjakovë

Frok Hajdaraj

Kuvendi Komunës GJAKOVË
Drejtoria për Kadastr Gjeodezi dhe Prone

KOPJE PLANI

Z.K. Gjakove J. Qytet
Poseduesi: 1 /1 Adem (Ramadan) Mahmutaj

Shk. zvog. 1: 500



Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale: _____

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m ²	
5105-7	-	-	oborr	-	0	04	24	
	-	-	shtepi	-	0	01	40	
Gjithësejtë					0	05	64	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastr duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

VËRTETON:
Arber Jusufi

